



Vendosja e çmimit maksimal nga Qeveria si masë mbrojtëse për konsumatorët – rasti i naftës

Qeveria e Kosovës, në qershor të këtij viti, përcaktoi marzhën tregtare maksimale të fitimit të naftës¹. Sipas Qeverisë, ky vendim është marrë me qëllim të rregullimit të çmimit të produkteve të naftës dhe mbrojtjes së konsumatorëve nga lëvizjet e mëdha të çmimeve në treg.

Përmes këtij udhëzimi administrativ, për një periudhë 30 ditore u vendos limiti i çmimit për produkte të naftës, ku shitësve me shumicë iu mundësua marzha tregtare e fitimit dy (2) centë € për litër, ndërkohë shitësve me pakicë dymbëdhjetë (12) centë € për litër.

Në këtë udhëzim u përcaktua edhe çmimi maksimal i lejuar i shitjes për litër të secilit produkt, i njohur ndryshe edhe si çmimi tavan.

Ky çmim u llogarit dhe u publikua çdo ditë nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), duke u bazuar në çmimin mesatar të furnizimit të dhjetë (10) milionë litrave të fundit për produktin dizel, një (1) milion për benzin dhe produkteve tjera të naftës nga Dogana e Kosovës, të cilave u shtohet edhe 12 centë për shpenzimet tjera duke arritur çmimin maksimal të lejuar të shitjes.

Përveç çështjes së ligjshmërisë, ky vendim i qeverisë ngriti edhe diskutime për dëmet dhe dobitë që mund të krijohen nga intervenimi i ekzekutivit në ekonominë e tregut të lirë.

Duke u bazuar në shembullin e produkteve të naftës, qeveria paralajmëroi²³ hartimin e projektligjit për mbrojtjen e furnizimit të produkteve themelore.

1 Qeveria e Republikës së Kosovës. Udhëzimi Administrativ NR. 03/2022 Për Rregullimin e Çmimeve të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtërishme dhe Masat e tjera Mbrojtëse. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=59904> (qasur për herë të fundit me 18.08.2022).

2 Qeveria merr vendim për çmimet e larta të produkteve themelore, Kosovapress. 2022. <https://kosovapress.com/qeveria-merr-vendim-per-çmimet-e-larta-te-produkteve-themelore/> (qasur për herë të fundit me 18.08.2022).

3 Me 24 gusht, Qeveria njoftoi plotësim/ndryshimin e udhëzimit administrativ për produktet e naftës, vendim ky që nuk është publikuar ende në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Kjo analizë e shkurtër paraqet konceptin e çmimit maksimal si formë e kontrollit të çmimeve, kornizës ligjore për këtë vendim, shqyrton ndikimin që ka pasur ky vendim në ndryshimin e çmimit të naftës në Kosovë dhe ofron rekomandime për Qeverinë për procesin e mbrojtjes së furnizimit të produkteve ushqimore me ligj.

Çka është çmimi maksimal dhe kur mund të aplikohet?

Çmimi maksimal i njohur ndryshe edhe si çmimi tavan, është një lloj i kontrollit të çmimit, ku përcaktohet çmimi maksimal që një shitësi i lejohej t'i vendos një malli apo shërbimi⁴. Zakonisht të përcaktuara me ligj nga një autoritet rregullues, çmimet maksimale vendosën në shumicën e rasteve për produkte esenciale, kur këto mallra bëhen të papërbalueshme për konsumatorët.

Kontrulli i çmimit ka një histori të gjatë të dokumentuar që nga revolucioni francez⁵, ndërkohë në shekullin e XX, kjo formë është përdorur shumë në disa shtete perëndimore gjatë Luftës së Dytë Botërore⁶, duke kulmuar me kontrollin e çmimeve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës⁷ (çmimet e naftës dhe produkteve ushqimore, qirasë, normës së interesit) dhe Mbretërinë e Bashkuar gjatë viteve 1970. Në përgjithësi, kontrulli i çmimeve nisi të largohej nga përdorimi gjatë viteve 1980, me qeveritë që favorizonin de rregullimin pas rënies së inflacionit⁸.

Vendosja e çmimit maksimal për mallra dhe shërbime bëhet zakonisht si formë e adresimit të inflacionit, monopoleve apo dallimit të madh mes kërkesës dhe ofertës në treg, me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve.

Përkrahësit e politikës së çmimit maksimal argumentojnë se një masë e tillë nevojitet për frenimin e ngritjes së çmimeve⁹. Në anën tjetër, kritikët argumentojnë se ky intervenim nuk adreson çështjen thelbësore të inflacionit, prish bilancin mes ofertës dhe kërkesës që rezultojnë në mungesë të furnizimit, inkurajon uljen e kualitetit të shërbimeve dhe mallrave si mundësi e rritjes së fitimit si dhe rrit burokracinë dhe shpenzimet për mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj mase¹⁰.



Çmimi maksimal i njohur ndryshe edhe si çmimi tavan, është një lloj i kontrollit të çmimit, ku përcaktohet çmimi maksimal që një shitësi i lejohej t'i vendos një malli apo shërbimi

⁴ Troy Segal, Price Ceiling. Investopedia, 2021. <https://www.investopedia.com/terms/p/price-ceiling.asp> (qasur për herë të fundit me 18.08.2022).

⁵ Fiona M. Scott Morton, The Problems of Price Controls. Cato Institute, 2001. <https://www.cato.org/commentary/problems-price-controls> (qasur për herë të fundit me 18.08.2022).

⁶ Justin-Damien Guentte, Price Controls: Good Intentions, Bad Outcome. World Bank Group, 2020. <https://documents1.worldbank.org/curated/en/735161586781898890/pdf/Price-Controls-Good-Intentions-Bad-Outcomes.pdf> (qasur për herë të fundit me 18.08.2022).

⁷ Gene Haley, Remembering Nixon's Wage and Price Control. Cato Institute, 2011. <https://www.cato.org/commentary/remembering-nixons-wage-price-controls> (qasur për herë të fundit me 18.08.2022).

⁸ Ben Casselman & Jeanna Smialek, Price Controls Set Off Heated Debate as History Gets a Second Look. The New York Times, 2022. <https://www.nytimes.com/2022/01/13/business/economy/inflation-price-controls.html> (qasur për herë të fundit me 18.08.2022).

⁹ Edison Jakurti, Le ta konsiderojmë vendosjen e çmimeve tavan. Sbuker, 2022. <https://sbunker.net/op-ed/91434/le-ta-konsiderojme-vendosjen-e-çmimeve-tavan/> (qasur për herë të fundit me 18.08.2022).

¹⁰ David R. Henderson, Price Controls: Still A Bad Idea. Hoover Institution. <https://www.hoover.org/research/price-controls-still-bad-idea> (qasur për herë të fundit me 18.08.2022).

Korniza ligjore për vendosjen e çmimit maksimal për produkte të naftës si masë mbrojtëse në Kosovë

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton qartë se ekonomia e tregut me konkurrencë të lirë është bazë e rregullimit ekonomik në vend¹¹.

Vendimet që kufizojnë konkurrencën e lirë janë të ndaluara, me përjashtim kur këto lejojnë në mënyrë eksplicite me ligj, siç është rasti me produktet e naftës dhe karburanteve të ripërtëritshme.

Veprimtaria me produkte të naftës dhe karburanteve të ripërtëritshme në Kosovë zhvillohet sipas parimeve të ligjshmërisë dhe konkurrencës së lirë, të përcaktuara me Ligjin për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtëritshme¹² (nga këtu e tutje, Ligji për Naftën).

Vendimi i Qeverisë për të intervenuar në tregun e naftës, u mbështet në nenin 15 të Ligjit për Naftën, i cili parasheh vendosjen e çmimit maksimal dhe margjinës së lejuar të shitjes me shumicë dhe pakicë në rastet kur ka:

- mungesa të papritura dhe të vazhdueshme të produkteve të naftës ose karburanteve të ripërtëritshme;
- fatkeqësi natyrore;
- mospërshtatje të çmimeve vendore me lëvizjet e mëdha të çmimeve në tregun botëror;
- dallim të pajustificueshëm të çmimeve vendore nga çmimet në vendet fqinje.

Në arsyetimin¹³ e MINT, udhëzimi administrativ u hartua me qëllim të mbrojtjes së konsumatorit, pasi në bazë të të dhënave të konfirmuara nga Dogana dhe Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), kishte mospërshtatje të çmimeve vendore krahasuar me lëvizjet në tregun botëror.

Identifikimi dhe marrja e masave në rastet kur ka mospërshtatje të çmimit ose shtrembërim të konkurrencës bie në përgjegjësinë e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës (AKK), i cili është institucioni më i rëndësishëm për rregullimin e tregut në Kosovë.

Megjithëse ky autoritet nuk ka mandat që të rregullojë çmimet e ndonjë produkti apo shërbimi, AKK ka mandat që të veprojë kur cenohet, pengohet apo shtrembërohet konkurrenca në treg, siç kishte vepruar me rastin e çrregullimit të konkurrencës në treg gjatë muajve nëntor dhe dhjetor të vitit 2018¹⁴, kur kishte gjobitur 14 kompani të derivateve të naftës me 4 milionë euro.

Për shkak të vonesës mbi një vjeçare në emërimin e anëtarëve të rinj të Komisionit (organ vendimmarrës i cili autorizon hetimet) të AKK-së, në Kosovë nuk ishte iniciuar asnjë aktivitet hetimor kundrejt çrregullimeve të mundshme në tregun e naftës.

Udhëzimi administrativ për çmimin maksimal nuk u bazua në hetimin paraprak të tregut nga AKK, por ky autoritet aprovoi propozim-vendimin e MINT për përcaktimin e marzhës maksimale të çmimit të naftës dhe karburanteve të ripërtëritshme, duke deklaruar se operatorët ekonomikë kanë mundësi të zhvillojnë garë brenda marzhës së përcaktuar.

¹¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës. 2008. Neni 10. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702> (qasur për herë të fundit me 18.08.2022).

¹² Qeveria e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 08/L-018 Për Tregtinë Me Produkte Të Naftës dhe Karburante të Ripërtëritshme. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=55139> (qasur për herë të fundit me 18.08.2022).

¹³ Qeveria merr vendim për çmimet e naftës. Koha, 2022. <https://www.koha.net/arberi/331379/qeveria-pritet-te-vendose-per-rregullimin-e-çmimit-te-naftes/> (qasur për herë të fundit me 18.08.2022).

¹⁴ Mbi 4 milionë euro gjoja për 14 kompani të derivateve. Kallxo, 2020. <https://kallxo.com/lajm/mbi-4-milione-euro-gjoja-per-14-kompani-te-derivateve/> (qasur për herë të fundit me 18.08.2022).

Efeki i vendosjes së çmimit maksimal të naftës në Kosovë

Çmimi i naftës është rritur vazhdimisht në vitin 2022, sidomos pas sanksioneve të shteteve të perëndimit ndaj Rusisë për shkak të fillimit të luftës në Ukrainë, ku krahasuar me verën e kaluar çmimi pothuajse u dyfishua, duke arritur nivelet më të larta që nga viti 2008¹⁵.

Kosova nuk ka rafineri të saj, andaj të gjitha karburantet i importon nga vendet e rajonit. Në Kosovë, çmimi i naftës në fillim të vitit 2022 sillej nga 1.25 € deri në 1.35 € për litër, ndërsa kulmi u arrit në fund të muajit qershor, ku një (1) litër naftë kushtonte mesatarisht 1.91 €, ¹⁶ një rritje mbi 50% për vetëm gjashtë muaj.

Për periudhën 30 ditore sa ishte në fuqi Udhëzimi Administrativ 03/2022 për Rregullimin e Çmimit të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtëritshme, çmimi mesatar ditor i naftës kishte rënë për 11.5% apo 22 centë, nga 1.91 € për litër sa ishte me 25 qershor, në 1.69 € për litër me 24 korrik 2022¹⁷.

Tabela e mëposhtme tregon se gjatë kohës sa ishte në fuqi ky udhëzim, çmimi i naftës në Kosovë në përgjithësi reflektoi trendin e çmimit në bursat ndërkombëtare¹⁸.

TABELA 1: Pasqyrimi i çmimit të naftës në bursën ndërkombëtare dhe çmimit mesatar të naftës në Kosovë gjatë periudhës sa ishte në fuqi udhëzimi administrativ.

Data:	Çmimi mesatar i 1 litre naftë (dizel) në Kosovë (€)	Trendi	Çmimi i një fuçi naftë të papërpunuar (WTI) në tregun ndërkombëtar (\$)	Trendi	Çmimi i një fuçi naftë të papërpunuar (Brent) ¹⁹ në tregun ndërkombëtar (\$)	Trendi
25.06.2022	1,91		105,2		107,54	
06.07.2022	1,78	-6.8%	94,7	-8.7%	97,23	-6%
16.07.2022	1,75	-8.3%	97	-5.8%	99	-4.3%
25.07.2022	1,69	-11.5%	96,5	-6.3%	100	-3.4%
06.08.2022	1,72	-9.9%	90,4	-12.2%	96	-7.2%

¹⁵ Scott Disavino, Oil price surges to highest since 2008 on delays in Iranian talks. Reuters. 2022. <https://www.reuters.com/business/energy/oil-price-set-surge-further-iranian-talks-delays-2022-03-06/> (qasur për herë të fundit me 18.08.2022).

¹⁶ Çmimi mesatar ditor për artikujt bazë. Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). https://askdata.rks-gov.net/pxweb/sq/ASKdata/ASKdata_Prices_Consumer%20Price%20Index_Daily%20indicators/cmimet_ditore.px/ (qasur për herë të fundit me 18.08.2022).

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Trading Economics. WTI Crude Oil. 2022. <https://tradingeconomics.com/commodity/crude-oil> (qasur për herë të fundit me 18.08.2022).

¹⁹ Trading Economics. Brent Crude Oil. 2022. <https://tradingeconomics.com/commodity/brent-crude-oil> (qasur për herë të fundit me 18.08.2022).

Nëse marrim si njësi krahasuese çmimin mesatar të naftës me 25 qershor 2022, (datën kur hyri në fuqi çmimi maksimal), vërejmë se rënia e çmimit të naftës në bursën ndërkombëtare gjatë 30 ditëve në vijim sa ka zgjatur kjo masë, është përcjell me rënie të çmimit mesatar edhe në Kosovë.

Për një muaj, çmimi i një fuçie naftë në bursën ndërkombëtare ka pësuar rënie prej 6.3% (WTI) dhe 3.4% (Brent), ndërkohë në Kosovë për këtë periudhë kemi rënie të çmimit të litrës së naftës (dizel) për 11.5%.

Situatë ndryshe paraqitet në 30 ditët para hyrjes në fuqi të çmimit maksimal, gjatë të cilave rënia e çmimit të naftës në bursën ndërkombëtare, ishte përcjell me ngritje të vazhdueshme të çmimit të naftës në Kosovë.

TABELA 2. Pasqyrimi i çmimit të naftës në bursën ndërkombëtare dhe çmimit mesatar të naftës në Kosovë gjatë periudhës një mujore para hyrjes në fuqi të çmimit maksimal.

Data:	Çmimi mesatar i 1 litre naftë (dizel) në Kosovë (€)	Trendi	Çmimi i një fuçie naftë të papërpunuar (WTI) në tregun ndërkombëtar (\$)	Trendi	Çmimi i një fuçie naftë të papërpunuar (Brent) ²⁰ në tregun ndërkombëtar (\$)	Trendi
26.05.2022	1,67		111.35		111.47	
01.06.2022	1,68	+0.5%	112,82	+0.4%	113,47	+1.7%
15.06.2022	1,84	+10.1%	110,78	-0.5%	115,31	+3.4%
17.06.2022	1,88	+12.5%	105,91	-4.8%	110,22	-1.1%
23.06.2022	1,91	+14.3%	101,42	-8.9%	103,33	-7.3%

Çmimi i naftës në bursën ndërkombëtare nuk është faktori i vetëm që ndikon në çmimin e naftës në Kosovë megjithatë, është faktori më i rëndësishëm për ndryshimin e çmimit në vend. Gjykuar në këtë aspekt, politika e çmimit maksimal ka rezultuar e suksesshme në përcjelljen e ndryshimeve në bursën ndërkombëtare. Faktorë të tjerë që ndikojnë në çmimin e naftës por që nuk janë pjesë e kësaj analize janë çmimi gjatë kohës kur është blerë, kostoja e transportit, akciza, detyrimet doganore, kostoja e zhdoganimit dhe shpedicionit, kostoja e matjes së cilësisë, tatimi mbi vlerën e shtuar, e të tjera.

Një nga shqetësimet kryesore që shoqërojnë politikën e vendosjes së çmimit maksimal, është rreziku se operatorët ekonomikë mund t'i rrisin drastikisht çmimet pas përfundimit të masës mbrojtëse, por kjo situatë nuk është paraqitur në Kosovë. Çmimi mesatar i një (1) litre dizel që nuk ka ndryshuar më shumë se tre (3) centë gjatë tri javë pas shfuqizimit të çmimit maksimal.

²⁰ Trading Economics. Brent Crude Oil. 2022. <https://tradingeconomics.com/commodity/brent-crude-oil> (qasur për herë të fundit me 18.08.2022).

FIGURA 1: Çmimi mesatar i një litre nafte gjatë tri jave pas shfuqizimit të udhëzimit administrativ



25 KORRIK

01 GUSHT

10 GUSHT

15 GUSHT

17 GUSHT



Një nga shqetësimet kryesore që shoqërojnë politikën e vendosjes së çmimit maksimal, është rreziku se operatorët ekonomikë mund t'i rrisin drastikisht çmimet pas përfundimit të masës mbrojtëse, por kjo situatë nuk është paraqitur në Kosovë. Çmimi mesatar i një (1) litre dizel që nuk ka ndryshuar më shumë se tre (3) centë gjatë tri javë pas shfuqizimit të çmimit maksimal.



Sipas kryetarit të Shoqatës së Naftarëve z.Fadil Berjani, MINT bëri gabim teknik në përlogaritjen e marzhës së fitimit. Sipas tij, përcaktimi i marzhës së fitimit poshtë ekuilibrit të tregut, dëmton bizneset e vogla të cilat nuk kanë kapacitetet të mjaftueshme financiare të mbulojnë kostot operacionale për kohë sa zgjat masa e çmimit maksimal, dhe mund të shpie deri te falimentimi i tyre.

Në ekonominë e tregut të lirë, në rastet kur me intervenim të shtetit zvogëlohet çmimi i një produkti, zakonisht rritet kërkesa për këtë produkt, ndërkohë kompanitë mund të ulin ofertën për shkak se zvogëlohet fitimi, dhe në këtë mënyrë mund të vjen deri te mungesa në treg e këtij produkti. Mirëpo, gjatë periudhës 30 ditore sa zgjati çmimi maksimal, nuk ka pasur probleme me furnizim apo ulje të ofertës.

Sipas kryetarit të Shoqatës së Naftarëve z.Fadil Berjani, MINT bëri gabim teknik në përlogaritjen e marzhës së fitimit²¹. Sipas tij, përcaktimi i marzhës së fitimit poshtë ekuilibrit të tregut, dëmton bizneset e vogla të cilat nuk kanë kapacitetet të mjaftueshme financiare të mbulojnë kostot operacionale për kohë sa zgjat masa e çmimit maksimal, dhe mund të shpie deri te falimentimi i tyre.

Sfidë në mbikëqyrjen e zbatueshmërisë vazhdon të jetë kapaciteti i ulët njerëzor i Inspektoratit të Tregut (MINT), duke qenë se janë vetëm 120 inspektorë të tregut²², të cilët janë përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të 15 ligjeve dhe mbi 30 akteve nënligjore. Në anën tjetër, incentiva për shmangie nga kontrolli është gjithmonë prezente tek operatorët ekonomikë, dhe një nga format më të thjeshta është ulja e cilësisë me qëllim të uljes së shpenzimeve për të rritur marzhën e fitimit²³.

Në rastin e përcaktimit të çmimit maksimal për naftën, operatorët ekonomikë në përgjithësi e kanë respektuar masën e çmimit maksimal, me Inspektoratin e Tregut (MINT) që realizoi 128 inspektime te operatorët ekonomikë që ushtrojnë veprimtarinë e shitjes me pakicë të derivateve të naftës. Gjatë 30 ditëve sa ishte në fuqi kjo masë, masa u morën vetëm ndaj 11 operatorëve ekonomikë që nuk respektuan udhëzimin administrativ.

Në Kosovë, mbikëqyrja inspektuese e cilësisë së naftës bëhet nga Inspektorati i Tregut, Dogana (para hyrjes së karburantit në tregun e brendshëm), dhe nga laboratorët testues të akredituar. Gjatë kohës sa ishte në fuqi udhëzimi për çmimin maksimal, asnjëra nga këto institucione nuk raportoi ndonjë rast të uljes së cilësisë së produkteve të naftës.

21 Komunikim direkt me z.Fadil Berjani në lidhje me efektet e çmimit maksimal te bizneset e naftës. 11.08.2022.

22 Ligji Nr.03/181 "Për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut". 2013. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2703> (qasur për herë të fundit me 18.08.2022).

23 Hugh Rockoff, Price Control. Econlib. <https://www.econlib.org/library/Enc/PriceControls.html> (qasur për herë të fundit me 18.08.2022).

Përfundime dhe rekomandime

Udhëzimi administrativ për çmimin maksimal u respektua në përgjithësi nga operatorët ekonomikë, nuk u raportua për mungesë të produktit apo rënie të kualitetit të naftës si dhe u shënua një rënie graduale e çmimit të naftës si reflektim i rënies së çmimit në bursën ndërkombëtare. Pra, siç dëshmohet në këtë punim, intervenimi i shtetit në përcaktimin e çmimit maksimal në produktin e naftës është treguar i suksesshëm.

Meqenëse Qeveria ka paralajmëruar hartimin e një projektligji për mbrojtjen e furnizimit me produkte themelore, D+ rekomandon Qeverinë si në vijim:

- Rregullimi i çmimeve me Ligjin për Mbrojtjen e Produkteve Themelore të bëhet në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës, Këshillin për Mbrojtjen e Konsumatorit, shoqatat e bizneseve dhe grupeve tjera të interesit, në mënyrë që të garantohet stabiliteti financiar i operatorëve ekonomikë që ndikohen nga këto masa;
- Ligji për Mbrojtjen e Produkteve Themelore duhet të përmbajë nene të cilat përcaktojnë dhe arsyetojnë saktë rrethanat kur mund të vendosën masat mbrojtëse si marzha e fitimit dhe çmim maksimal;
- Hartimi i Ligjit për Mbrojtjen e Produkteve Themelore është instrumenti i duhur pasi intervenimi i Qeverisë në ekonominë e tregut të lirë është i ndaluar të bëhet përmes akteve nënligjore, sipas nenit 119 të Kushtetutës së Kosovës²⁴. Ndërhyrja në konkurrencën e lirë mund të bëhet vetëm kur ligji në mënyrë eksplicite lejon një intervenim të tillë, siç është rasti me ligjin për naftën, konkretisht nenin 15 i cili përcakton rregullimin e çmimeve dhe masave të tjera mbrojtëse;
- Rregullimi i çmimeve të bëhet vetëm për periudha të përkohshme, të përditësohet në afate të arsyeshme përmes akteve nënligjore që burojnë nga ky ligj, duke iu referuar çmimeve të tregut dhe normës së inflacionit në mënyrë që marzha e fitimit të jetë e përballueshme për operatorët ekonomikë;
- Qeveria duhet të sigurojë që rregullimi i çmimeve të produkteve themelore me ligj të mos zgjatet përtej rrethanave të jashtëzakonshme;
- Ligji për Mbrojtjen e Produkteve Themelore duhet të adresojë specifikat e veçanta të secilit produkt, duke qenë se bëhet fjalë për produkte të ndryshme që kanë dallime mes vete, ndaj rregullimi uniform nuk është i përshtatshëm;
- Qeveria në bashkëpunim me operatorët ekonomikë duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme që të garantohet furnizimi me produkte themelore, në mënyrë që të mos vie deri te mungesa e produkteve, apo pritjet e gjata për furnizime;
- Të rriten kapacitetet njerëzore të Inspektoratit të Tregut përmes lëvizjes së stafit brenda administratës publike, në mënyrë që të shtohen inspektimet që garantojnë kualitetin e produkteve dhe respektimin e rregullave të konkurrencës nga ana e operatorëve ekonomikë;
- Inspektorati i Tregut të bëjë mbikëqyrjen e tregut pas përfundimit të masave mbrojtëse për produktet themelore, në mënyrë që të evitohet ndonjë ngritje e madhe artificiale e çmimeve pas shfuqizimit të këtij ligji;
- Të shqyrtohet mundësia që krahas masave mbrojtëse intervenuese, të zvogëlohen apo largohen normat e akcizës dhe TVSH-së për produktet themelore.

²⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 119, pika 3 "Veprimet që kufizojnë konkurrencën e lirë përmes vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese, ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, janë të ndaluara, me përjashtim kur këto lejohen në mënyrë eksplicite me ligj".

